Njoftim për përqendrimin me të cilin ALTA PASS SHPK, Serbi dhe Aleksandra Orliq, Serbi, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi S – BLUE SHPK, Serbi
(Lënda nr. 08-148/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më 14.10.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrimin me të cilin ALTA PASS SHPK Beograd (ALTA PASS SHPK Beograd), shoqëri tregtare me seli në adresën Ugrinovaçka nr. 223, 11000 Beograd – Zemun, Republika e Serbisë, dhe Aleksandra Orliq, shtetase e Republikës së Serbisë, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi S – BLUE SHPK Suboticë (S – BLUE DOO Subotica), shoqëri tregtare me seli në adresën rr. Anton Ashkerc nr. 42/32, 24000 Suboticë, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

ALTA PASS SHPK Beograd është shoqëri e sapokrijuar, e themeluar me qëllim të realizimit të transaksionit (SPV – shoqëri për qëllime të veçanta), dhe deri në ditën e paraqitjes së njoftimit nuk ushtron asnjë veprimtari afariste, por shërben ekskluzivisht për nevojat e transaksionit. Shoqëria është e regjistruar për veprimtarinë e tregtisë me shumicë të paspecializuar. ALTA PASS bën pjesë në Grupin ALTA, i cili ka si fokus kryesor shërbimet bankare dhe shërbimet e ndërlidhura financiare.

Grupacioni ALTA është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes ALTA Banka SHA Manastir, e cila ushtron veprimtari bankare dhe ka prani në Shoqërinë për Tregti dhe Shërbime PELAGONIJA FINANCE SHPK Shkup – në likuidim, e cila ushtronte veprimtari të menaxhimit. PELAGONIJA FINANCE SHPK Shkup është shoqëri në likuidim dhe, për këtë arsye, nuk ushtron veprimtari afariste.

Që nga viti 2026, Grupi ALTA është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut edhe përmes shoqërisë aksionare ALTA OSIGURUVANJE SHA Shkup, me veprimtari të sigurimit të jojetës, si dhe përmes ALTA GROUP SHPKNJP Shkup, me veprimtari të ndërmjetësimit tjetër monetar, dhe ALTA REAL ESTATE SHPKNJP Shkup, me veprimtari të dhënies me qira dhe administrimit të pasurive të paluajtshme në pronësi ose të marra me qira (lizing).

S – BLUE SHPK Suboticë ushtron veprimtari që lidhen me shërbimet e pagesës elektronike të tarifave rrugore, duke përfshirë shpërndarjen e pajisjeve TAG dhe shërbimet e rimbushjes së pajisjeve TAG.

Për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës i produkteve të përkufizohet si tregu i shërbimeve që lidhen me pagesën elektronike të tarifave rrugore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë: a) shpërndarjen e pajisjeve TAG dhe b) shërbimet e rimbushjes së pajisjeve TAG.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar mbi këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara që të dorëzojnë vërejtje dhe mendime në lidhje me këtë përqendrim pranë Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose përmes e-mailit: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

15.10.2026
Shkup